



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:172257

Datë: 02.09.2024

Numri i dokumentit: 06171282

KA.nr.586/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “N.T.Sh. Klinika Gjinekologjike Gjermane Deutsche Frauenklinik” (N.J.Sh. BI) me NUI 811282029 dhe seli magjistralen Prishtinë-Ferizaj në Prishtinë, të cilin në bazë të prokurës e përfaqësojnë avokatët Hamdi Podvorica dhe Fatlum Podvorica me seli në Ulpiana C-2, H-1, nr. 7 në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Shëndetësisë, Inspektorati Shëndetësor me seli në Prishtinë, objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 23.07.2024 në të cilën mori pjesë përfaqësuesi i paditësit, ndërsa i padituri mungoi, më 1 shtator 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “N.T.Sh. Klinika Gjinekologjike Gjermane Deutsche Frauenklinik” (N.J.Sh. BI) me NUI 811282029 kundër të paditurit Ministria e Shëndetësisë, Inspektorati i Shëndetësor, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr.10/K-81-20 të datës 09.11.2020 të së paditurit dhe anulimin e vendimit nr. 10/B-013-20 të datës 01.07.2020 të Inspektoratit Farmaceutik, si dhe kthimin e shumës prej 1000€ në emër të gjobës së shqiptuar.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet procedurale lidhur me këtë procedurë të konfliktit administrativ.

A R S Y E T I M

- I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve
  1. Paditësi përmes padisë së datës 08.12.2020 e ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të Paditurit me kërkesë për anulimin e akteve administrative me nr. Prot. 05-3904 të datës 03.07.2020 të Inspektoratit Farmaceutik dhe vendimi me nr. prot. 05-6459/2 të datës

06.11.2020 të Inspektoratit Shëndetësor, ndërsa gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të mbajtur më datë 04.07.2024 i njëjti ka bërë zgjerimin e padisë në aspektin objektiv duke i propozuar gjykatës që të detyroj të paditurin t'ia kthej paditësit shumën e inkasuar prej 1000€.

2. Ai në padi ka deklaruar se vendimi i goditur përfshihet me të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe arsyet e vendimit, si dhe në arsyetimin e vendimit nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare. Sipas tij nga provat e bashkangjitura ankesës si raporti i inspektimit me nr.prot. 05-3903 të datës 03.07.2020 dhe procesverbali me nr. serik 00003 i datës 12.05.2020, duke rezultuar se nga dita e inspektimit të kryer më datë 12.05.2020 te paditësi deri në marrjen e vendimit ka kaluar periudha 6 mujore, andaj meqë ka kaluar ky afat kohor Inspektorati Farmaceutik nuk ka pasur të drejtë ligjor që të lëshoj një vendim pas kalimit të këtij afati si dhe duke i shqiptuar dënim më të lartë se sa që parashihet sipas nenit 16 par. 1 të Udhëzimit Administrativ nr.11/2015 për Qarkulluesit Farmaceutik me Pakicë për Produktet dhe Pajisje Medicinale duke tejkaluar kompetencën e tij me rastin e shqiptimit të gjobës në shumë prej 1,000.00 euro.
3. Sipas tij, ai i ka plotësuar që të gjitha kushtet e parapara ligjore të domosdoshme për licencimin dhe është licencuar nga organi kompetent AKPPM, andaj me rastin e licencimit nuk i është kërkuar edhe ndonjë pajisje tjetër e veçantë. Më tutje ka deklaruar, se Inspektorati është dashur që fillimisht të këshillojë paditësin për mungesa eventuale të ndonjë aparati dhe t'i jep një afat shtesë kohor të nevojshme për plotësimin e mungesave eventuale, ndërsa vetëm pas kalimit të këtij afati të dhënë në rast se ai nuk do t'i plotësonte vërejtje e kërkuara nga Inspektorati atëherë do të mund t'i shqiptohet ndonjë masë apo gjobë.
4. Përfundimisht ka deklaruar se Inspektorati Shëndetësor përmes vendimit të kundërshtuar nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike prandaj edhe masa mbi shqiptimin e gjobës është e kundërligjshme.
5. I Padituri në përgjigje e tij në padi e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e Paditësit dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj atë. Ka deklaruar se vendimet e goditur janë të drejta dhe të ligjshme, meqenëse është vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe baza juridike është Ligjin për Inspektoratin Shëndetësor, UA 11/215 dhe UA01/2010. Sipas tij, gjatë kontrollit të inspektoratit të datës 12.05.2020 është hartuar procesverbali mbi inspektimin

e kryer dhe të gjeturat e inspektoratit janë përshkruar në procesverbal, ku të njëjtin e ka nënshkruar edhe Paditësi pa vërejtje.

## II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

6. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e prova. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: vendimi me numër 10/K-81-20 i datës 09.11.2020; ankesa e paditësit e protokolluar te i padituri me numër 05-6459 më 12.10.2020; vendimi numër 10/B-013-20 i datës 01.07.2020 i Inspektoratit Farmaceutik; fatura me numër serik 0000643 e datës 01.07.2020 e Ministrisë së Shëndetësisë për paditësin; raporti i inspektimit në emër të paditësit me numër të referencës 10/B-036-20 i datës 01.07.2020; procesverbali mbi inspektimin e kryer me numër serik 00003 i datës 12.05.2020; të gjitha shkresat e lëndës të procedurës administrative të dorëzuara nga i padituri në bazë të kërkesës së dytë të gjykatës; urdhri i përmbauesit privat Arsim Bajraktari me shenjë P.nr. 227/22 i datës 06.06.2024 së bashku me pasqyrën e shpenzimeve; urdhërpagesa kombëtare me numër 1341481 e datës 04.06.2024 e lëshuar nga Teb Banka; urdhërpagesa kombëtare me numër 1341485 e datës 04.06.2024 e lëshuar nga Teb Banka; fatura numër 277/24 e datës 04.06.2024 lëshuar nga përmbauesi privat Arsim Bajraktari për paditësin, si dhe parashtresa – deklarimi për seancën e datës 23.07.2024 nga ora 13:30 i Avokaturës Shtetërore.
7. Gjykata pas analizimit të provat të cekura më lartë në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe duke i zbatuar rregullat e të provuarit nga neni 322 i LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së e konstatoi gjendjen faktike të përshkruar më poshtë.
8. Inspektorati Farmaceutik më 12.05.2020 ka kryer inspektim ad-hoc te Paditësi dhe kishte vërejtur se barnatorja nuk posedon receta në barnatore, nuk posedon termohigrometër për monitorimin e temperaturës dhe lagështisë, nuk janë prezantuar listat e regjistrimit, barnat me afat të skaduar nuk janë regjistruar në lista, si dhe nuk e ka të etiketuar hapësirën ku ruhen produktet medicinale me afat të skaduar dhe të pa përdorshme. Gjithashtu, Paditësi ishte urdhëruar që të pajiset me termohigrometër, t'i ruaj recetat në barnatore dhe të operoj me produkte medicinale me afat të skaduar sipas dispozitave ligjore në fuqi. Paditësi e kishte nënshkruar pa vërejtje procesverbalin e inspektimit. Këto

fakte gjykata i vërtetoi përmes procesverbalit mbi in mbi inspektimin e kryer me numër serik 00003 të datës 12.05.2020.

9. Pas kësaj, Inspektorati Farmaceutik përmes vendimit me nr. 10/B-013-20 të datës 01.07.2020 e ka ndëshkuar Padiësin me gjobë prej 1000€. Në vendim kishte arsyetuar se gjatë inspektimit kishte konstatuar se Padiësi nuk kishte poseduar termohirometër për monitorimin e temperaturës dhe lagështisë, rrjedhimisht ka vepruar në kundërshtim me dispozitat në fuqi. Këto fakte gjykata i konstatoi përmes vendimit të sapo cekur.
10. Padiësi më datë 12.10.2020 ka paraqit ankesë kundër vendimit të shkallës së parë, të cilët Kryeinspektori Shëndetësor përmes vendimit me nr. 10/K-81-20 të datës 09.11.2020 e ka refuzuar si të pa bazuar. I Padituri kishte arsyetuar se ka konstatuar që Padiësi ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 37 par. 2 dhe 3 të Ligjit nr. 04/L-190 për Produktet dhe Pajisjet Medicinale, nenit 4 para.5 nënpara. 5.2, nenit 12 para.6, nenit 16 para.1 nënpara. 1.1 dhe 1.5 të Udhëzimit Administrativ 11/2015 për Qarkulluesit Farmaceutik me Pakicë për Produktet dhe Pajisje Medicinale, nenit 10 para.3 të Udhëzimit Administrativ 01/2010 për Recetat në Sistemin Shëndetësor në Republikën e Kosovës.
11. Përfundimisht, gjykata konstaton se i Padituri në procedurën përmbartimore e ka përmbartuar shumën e gjobës së shqiptuar me vendimin e shkallës së parë. Këto fakte gjykata i konstatoi përmes urdhrin P.nr.227/22 të datës 06.06.2024 të përmbartuesit privat Arsim Bajraktari me seli në Prishtinë, si dhe dokumentet tjera në lidhje me atë lëndë përmbartimore.
12. Provat tjera të administruara nga gjykata nuk provuar ndonjë fakt tjerët relevant lidhur me këtë çështje, prandaj gjykata vendosi të mos lëshohet në elaborimin e hollësishëm të tyre.

### III. Vlerësimi meritor i rastit

13. Gjukata pas i mori parasysh të gjitha pretendimet e ndërgjyqësve, gjendjen faktike të konstatuar, si dhe pas analizimit të dispozitave juridike të shqyrtuara më poshtë, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e Padiësit është e pabazuar në ligj, rrjedhimisht kërkesëpadia e Padiësit duhet të refuzohet.

14. Në rend të parë, gjykata gjeti se i Padituri e ka zbatuar procedurën administrative në përputhje me LPPA-në dhe dispozitat procedurale të paraparë me ligjet e veçanta, si dhe i Padituri ka qenë kompetent për dhënien e aktit administrativ të goditur. Gjykata e gjen të pabazuar pretendimin e Paditësit se Inspektorati Farmaceutik pas gjashtë muajve nga inspektimi e ka dhënë vendimin e shkallës së parë. Në këtë drejtim gjykata rikujton se inspektimi ishte kryer më 12.05.2020, ndërsa vendimi i shkallës së parë është dhënë më 01.07.2020 (protokolluar më 03.07.2020), që i bie më pak se dy muaj nga dita e inspektimit. Përveç kësaj, gjykata e gjen të pabazuar edhe pretendimin e Paditësi se vendimi i goditur ka të meta formale, pasi vendimi i goditur përveç që i përmban të gjitha elementet e nevojshme të përcaktuar me nenin 47 të LPPA-së, si dhe arsyetimi i vendimit të goditur i përmban të gjitha të dhënat nga neni 48 dhe 134 i LPPA-së.
15. Po ashtu, gjykata vëren se i Padituri e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike. Gjykata vëren se Paditësi në asnjë moment nuk ka ngritur pretendime se janë të pasakta konstatimet e të Paditurit për mungesën e termogigrometrit dhe mungesën e etiketimit dhe veçimit të produkteve medicinale me afat të skaduar, për të cilat ishte gjobitur. Madje, edhe procesverbalin e inspektimit, në të cilin fillimisht janë bërë ato konstatime, e kishte nënshkruar pa vërejtje. Prandaj, gjykata vlerëson se gjendja faktike e vërtetur nga i Padituri është e njëjta me gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata, gjegjësisht për gjykatën është vërtetuar se Paditësi nuk ka pasur termohigrometër për monitorimin e lagështisë në hapësirat e barnatores dhe nuk e ka pasur të veçuar dhe etiketuar hapësirën për ruajtjen e produkteve medicinale me afat të skaduar. Gjykata rikujton se, sipas nenit 322 para. 2 të LPK-së, barra e të provuarit i takon Paditësit për të vërtetuar se konstatimet e të Padituri nuk kanë qenë të sakta, përderisa në shkresat e lëndës administrative nuk rrjedh diçka tjetër. Në anën tjetër, gjykata vë në pah se Paditësi kishte pretenduar se ai i ka plotësuar të gjitha kushtet me rastin e licencimit, ndërsa me rastin e inspektimit është dashur të këshillohet për mungesat eventuale dhe t'i jepet një afat për plotësimin e atyre mungesave. Në lidhje me këtë, gjykata sqaron se nuk ka qenë fare kontestuese se Paditësi ka qenë i licencuar, siç rrjedh edhe nga vet procesverbali i inspektimit, rrjedhimisht plotësimi i kushteve ligjore në momentin e licencimit nuk ishte objekt i shqyrtimit të këtij konflikti administrativ. Fakti se Paditësi ka qenë i licencuar, pra i ka plotësuar kërkesat ligjore për licencim, nuk e liron atë nga obligimi që ushtrimin

e aktivitetit farmaceutik ta ushtroj në përputhje me aktet nënligjore, rrjedhimisht shkelja e atyre akteve bartë me vete pasoja juridike.

16. Përveç kësaj, gjykata vlerëson se i Padituri në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale administrative. Sipas neni 4 para. 5 nënpara. 5.1 të Udhëzimit Administrativ nr. 11/2015 për Qarkulluesit me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale (këtu e tutje UA 11/2015) “*Pajisje të domosdoshme për zhvillimin e veprimtarisë si qarkullues me pakicë të produkteve dhe pajisjeve medicinale janë: (...) 5.2. Pajisjet që sigurojnë temperaturën dhe lagështinë e hapësirave në përputhshmëri me deklaratën e prodhuesit për ruajtjen e produkteve dhe pajisjeve medicinale dhe produkteve tjera, si dhe pajisjet adekuate që e bëjnë regjistrimin permanent të temperaturës dhe lagështisë së këtyre hapësirave ku ruhen produktet dhe pajisjet medicinale (...)*”. Nga kjo dispozitë rrjedh obligimi i pashmangshëm i Paditësit që të jetë i pajisur me termohigrometër për monitorimin e temperaturës dhe lagështisë në hapësirat e barnatores. Gjithashtu, neni 12 para. 6 të UA 11/2015 ka përcaktuar se “*Produktet medicinale dhe produktet tjera me afat të skaduar, të dëmtuara apo janë të papërdorshme në ndonjë mënyrë tjetër, është obligative të ndahen dhe të grumbullohen në vendin e posaçën për këtë qëllim ku qartë shënohet “Jashtë përdorimit”. Të gjitha produktet nga kjo kategori duhet të evidentohen dhe kjo listë duhet të qëndroj në të njëjtin vend me këto produkte.*” Nga kjo dispozitë rrjedh obligimi i Paditësit që produktet me afat të skaduar t’i ndaj në hapësira të veçanta së bashku me listën e atyre barnave dhe me etiketimin se janë jashtë përdorimit.
17. Në anën tjetër, UA 11/2015 në nenin 16 para. 1.1 dhe 1.5 ka paraparë se “*Ndëshkimet në vlerë prej 500 eurove, shqiptohen për shkeljet: 1.1 Neni 4 paragrafi 5, për ndryshimet e bëra pas marrjes së licencës (...) 1.5. neni 12 paragrafi 4, 6*”. Nga këto dispozita rrjedh se, i Padituri ka të drejtë që shqiptoj gjobë në 500€ për çdo shkeljet nga neni 16 i UA 11/2015, meqenëse fjalët “ndëshkimet” dhe “shkeljet” janë përdorur në shumës. Duke u nisur nga fakti se i Padituri në bazë të inspektimit të tij te Paditësi i ka konstatuar dy shkelje të ndryshme, të cilat nuk e konsumojnë e as përjashtojnë njëra-tjetrën, atëherë për këtë gjykatë gjoba prej 1000€ është në harmoni me numrin e shkeljeve të ndryshme të konstatuara dhe lartësinë e gjobës së paraparë për ato shkelje me atë udhëzim administrativ.
18. Kjo gjykatë e gjen të pabazuar pretendimin e Paditësit se Inspektorati Farmaceutik nuk ka pasur të drejtë që menjëherë të shqiptoj gjobë, por është dashur t’i jep afat Paditësit

për evitimin e shkeljeve. Siç rrjedh nga procesverbali i inspektimit, i Padituri e ka urdhëruar Paditësin që t'i evitoj të metat e konstatuara, pa i caktuar afat. Megjithatë, meqenëse për shkeljet e konstatuara ishte paraparë shqiptimi i gjobës, atëherë për këtë gjykatë dispozitat për caktimin e afatit për evitimin e të meta të konstatuara nuk zbatohen në këto raste, për ndryshe shqiptimi i gjobës do të kishte kushtëzuar shprehimisht përmes normës juridike me dhënien e afatit për eliminimin e shkeljeve, për të cilat shqiptohet gjobë.

19. Gjykata i pati parasysh edhe pretendimet tjera të Paditësit, por gjeti se ato nuk ishin relevante për të vendosur ndryshe nga dispozitivi i këtij aktgjykimi.
20. Në anën tjetër, meqenëse nuk është vërtetuar kundërligjshmëria e aktit administrativ të goditur, atëherë për këtë gjykatë nuk ekziston baza ligjore nga nenin 17, 26 para. 2 nënpara. 3 lidhur me nenin 46 para. 5 i LKA-së që të detyroj të Paditurit që t'ia kthej Paditësit shumën prej 1000€ të realizuar në procedurën e përmbarimit, meqenëse dispozitat e sapo cekura mundësojnë kthimin e sendit vetëm nëse anulohet akti administrativ i goditur, rrjedhimisht e refuzoi kërkesëpadinë e Paditësit edhe për këtë pjesë.
21. Prandaj, meqenëse procedura që i ka paraprirë nxjerrjes së aktit administrativ të goditur është zbatuar në tërësi sipas rregullave të procedurës administrative, duke qenë se akti administrativ i goditur është dhënë në përputhje me nenet 47, 48 dhe 134 të LPPA-së, duke marrë parasysh se i Padituri e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike, siç është sqaruar edhe në pjesën e gjendjes faktike në këtë arsyetim, gjykata vjen në përfundim se nuk është plotësuar asnjë kusht ligjore nga nenit 52 i LPPA ose nenit 16 i LKA për anulimin e aktit administrativ të goditur, rrjedhimisht e refuzoi kërkesëpadinë e Paditësit për anulimin e aktit administrativ të goditur.
22. Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 63 të LKA-së.
23. Për arsyet e cekura më lartë, gjykata duke u bazuar në nenet 13, para. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.586/22

Gjyqtari

---

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.